

V E N D I M
Nr.337, datë 3.7.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.476, DATË
10.10.1994 “PËR KRITERET E STREHIMIT TË ISH-TË DËNUARVE DHE TË
PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST”**

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ish-të Përndjekurve Politikë pranë Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.476, datë 10.10.1994, ndryshohet si vijon:

“Të gjithë ish-të dënuarit dhe të përndjekur politikë, të cilët mendojnë se u takon strehim nga kontingjenti i banesave i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të paraqesin në zyrat lokale të Drejtorisë së Përgjithshme të ish të Përndjekurve Politikë vërtetime të bashkive të rretheve, që konsiderohen të pastrehë në bazë të pikave 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.49, datë 29.1.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi